



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

- Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit.-

Numër: 01-060/01-55051

Pejë, datë: 29.07. 2024.

PROCESVERBAL

Nga takimi i VI-të i rregullt i Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit të KK Pejë, i mbajtur me datë: 29. Korrik 2024, me fillim në orën 13:00 h.

Takimi u mbajt në Zyren e KPF-ca të KK. Pejë.

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesja znj. Valbona Avdijaj.

Kryesuesja, fillimisht konstatoi se në takim prezantojnë shumica e anëtarëve të KKMM dhe se ekziston kuorumi për mbajtjen e takimit, ngase në takim prezantojnë: 4 (katër) nga 7 (shtatë) anëtarët e Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit, mungojnë me arsye: z. Atdhe Krasniqi, znj. Sauda Pantinaj dhe z. Adnan Daciq.

Pos anëtarëve të KKMM prezenton: z.Agron Nikqi, drejtor i Drejtorisë për Punë Komunale dhe z.Myftar Shala, Inspektor i Drejtorisë për Punë Inspektuese Pejë dhe përfaqësuesja e Lets'Duit Peja znj. Diesa Morina.

Pas konstatimit se ekziston kuorumi për mbajtjen e takimit ngase në takim prezantojnë shumica e anëtarëve të KKMM.-sit, kryesuesja znj. Valbone Avdijaj, hapi takimin e KKMM dhe për këtë takim propozoi dhe nga të pranishmit njëzërit pa vërëjtje, u miratu ky

REND DITE :

- 1) Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të Komitetit Këshilldhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe mungesat.**
- 2) Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i V- të i rregullt i Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit, mbajtur me datë: 19.06.2024.**
- 3) Përkujdesje për mbrojtjen nga akustika, zhurma nga ambientet hoteljere dhe marrja e masave nga Inspekcioni dhe Institucionet tjera kompetente.**

- 4) Çështjet tjera aktuale lidhur me çështjet e ambientit në Komunën e Pejës.
- 5) Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo anëtarët.

I.

Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të Komitetit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe mungesat.

Në këtë takim prezentojn 4 (katër) nga 7 (shtatë) anëtarët e KKMM-it, mungon me arsye: z. Adhe Krasniqi, znj. Sauda Pantinaj, dhe z. Adnan Daciq.

II.

Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i V-të i rregullt i Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit, i mbajtur me datë: 19. Qershor 2024.

Procesverbali u miratua njëzëri pa vërejtje.

III.

Përkujdesje për mbrojtjen nga akustika, zhurma nga ambientet hoteljere dhe marrja e masave nga Inspekcioni dhe Institucionet tjera kompetente.

Znj. Valbona Avdijaj, fillimisht shtroi për shqyrtim çështjen në fjalë: mbrojtjen nga akustika dhe zhurma jasht normave të lejuara me dispozitat ligjore në ambientet e banuara në Komunën e Pejës, duke shtruar njëkohësisht pyetje për inspektionin se a mirren masa për mbrojtje në këtë drejtim dhe se cilat janë ato.

z. Ilir Thaçi, kërkoi nga përfaqësuesi i inspektionit, të informon në pika të shkurta lidhur me gjendjen e akustikës, nivelin e saj në komunën e Pejës, a është në suaza të normales, a ka tejkalime, e nëse po, a mirren masa në raste të tejkalimeve dhe keqpërodirimeve dhe cilat janë ato?

z. Myftar Shala, inspektor i Drejtorisë për Punë Inspektuese të Komunës së Pejës, informoi anëtarët e pranishëm të KKMM-sit lidhur me gjendjen në terren lidhur me zhurmën – akustikën dhe për masta që ndërmirën në rastet e tejklimit në Komunën e Pejës. Ankesa zyrtare nga qytetrët për pengesa nga akustika e zhurma nuk ka patur, por pavarësisht kësaj ne kemi vepruar në mënyrë preventive. Ka pasur raste ku janë lëshuar licenca nga ana e institucionit kompetent komunal për lejimin e orarit për manifestime të ndryshme ku ka pasur raste ku zhurma dhe akustika ka qenë më e theksuar. Ne monitorimin dhe kontrollin e kemi bërë në bashkëpunim me organet e rendit dhe qetësisë publike. Niveli i zhurmes është caktuar dhe planifikuar nëpër zona të ndryshme lokale në harmoni me ligjin.

znj. Valdrine Gashi- anëtare, shtroi pyetje për drejtorin dhe inspektorin, se: a ka mundësi që orari i grumbullimit të mbeturinave në qytet, në rrugët kryesore të ndryshohet – harmonizohet me nevojat dhe mundësit e sezonit veror, të bëhen më vonë natën apo heret në mengjes, për të eliminuar pengesat në qarkullim me vetura në qytet për qytetar.

Inspektori, informoi lidhur me pyetjen e shtruar nga parafolësja duke theksuar se ka pas komunikim me ndërmarrjen publike dhe se është duke u punuar në këtë drejtim për hartimin e planit dhe orarit të ri i cili do të aplikohet kryesisht në sezonën e verës për grumbullimin e mbeturinave në Komunën e Pejës. Ai njëkohësisht informoi edhe për çështjen e akustikës në qendër të qytetit “Korzo”ku muzika, zhurma, muzika me tupana, tarabuka, në diskota etj. është dukshëm më e theksuar, dhe masat që janë ndërmarrë dhe po ndërmerren në këtë drejtim, duke theksuar se kjo gjendje së shpejti do të ndryshoi, ngase nga shtatori mbyllet pjesa kryesore për shkak se do fillohet me realizimin e planit ndërtimor për qendër.

Znj.Fëllënza Podrimqaku Gashi,kërkoi saqirime lidhur me lëshimin e lejes dhe kushteve që duhet plotësuar për leje mjedisore komunale.

Inspektori, sqaroi se kjo bëhet bazuar në ligje dhe rregullore komunale.

Në fund u konkludua se institucionet komunale duhet të veprojnë në të gjitha rastet në implementim dhe marrjen e maseve adekuate varësisht nga shkeljet në harmoni me Ligjet dhe Rregulloret në fuqi, se duhet aplikuar rregullorja për orarin e punës, rregullorja për licenca dhe rregulloret tjera komunale në fuqi.

IV.

Çështjet tjera aktuale lidhur me çështjet e ambientit në Komunën e Pejës.

Në diskutim muarrën pjesë: Valbona Avdijaj, Ilir Thaçi, Fëllanza Podrimqaku Gashi, Valdrine Gashi, drejtori z.Agron Nikqi, dhe inspektori z. Myftar Sahala, duke trajtuar çështje të ndryshme si: çështjen e mbeturinave, hudhjen e tyre vend e pa vend, grumbullimin e tyre, planin e grumbullimit, orarin e grumbullimit, çështjen e kontejnerëve, ujrat e zeza, kanalet, mirëmbajtjen e tyre, kanalën në Fidanishte, kanalizimet e lagjeve, kanalet e hapura dhe hudhja e mbeturinave në to, punët dhe investimet në Asllan Qesme, kanalet e thella që po paraqesin rrezik dhe se duhet vendosur hekra mbrojtëse në ato pjesë për siguri të banorëve atje, trupa ndriquese dhe mirëmbajtja etj.

V.

Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo anëtarët.

Nuk pati çështje të ngritura.

Mëqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk u paraqitën, kryesuesja e takimit znj. Valbona Avdijaj e shpalli të mbyllur këtë takim në orën 14,35 h.

Pejë, dt.29. Korrik 2024

Procesmbajtësi,

Illir Thaçi

Kryesuesja e KKMA

Valbona Avdijaj